

## 4.4 AUTONIVELANT EPOKSID

### EPOFLOOR UNI-8900



Njësia matëse	copë/paletë	Konsumi	Ngjyra/specifikime të tjera
5 kg/kovë 15 kg/kovë	36 cp/paletë 12 cp/kuti	1.5 kg/m <sup>2</sup> /mm	Gri/transparent



#### EPOFLOOR UNI 8900

Vetënivelues me bazë epokside, 2 komponentësh.

#### PËRSHKRIMI

EPOFLOOR UNI 8900 është një produkt nivelizues me bazë rezinash epokside, si dhe nuk përmban solvent. Ofron avantazhet e mëposhtme:

- Rezistenca të larta mekanike.
- Lidhje shumë e mirë me sipërfaqen ku aplikohet.
- Rezistencë e lartë ndaj lageshtirës.
- Ka aftësi shumë të mira nivelizuese.
- Nuk ka efekt korrodues.

Klasifikohet si SR - B2,0 - ARO,5 - IR4 sipas EN 13813.

#### FUSHAT E APLIKIMIT

EPOFLOOR UNI 8900 përdoret si shtresë niveluese në dyshemetë me bazë çimento per ti dhënë rezistenca të larta mekanike dhe kimike. Është i përshtatshëm për aplikim në zonat industriale, magazina, parkingje, supermarkete, laboratore, hotele, garazhe, pika karburanti si dhe zona me trafik të rënduar. Gjithashtu është i përshtatshëm për të qenë një kontakt direkt me produkte ushqimore, sipas legjislacionit W - 347, ISO 8467.

#### UDHËZIME PËR PËRDORIM

##### 1. Sipërfaqja

Sipërfaqja ku do të aplikohet duhet të jetë:

- E qëndrueshme dhe e thatë ose me pak lagështi, pa praninë e ujit.
- E pastër, pa materiale që parandalojnë lidhjen, të tilla si pluhur, grimca të lirshme, yndyrna, etj
- E mbrojtur nga lagështia.

##### 2. Astarosja

Në sipërfaqe duhet të aplikohet astari EPOXY PRIMER W 4000. Konsumi 200 – 300 g/m<sup>2</sup>. Pasi astari të jetë tharë dëmtimet ekzistuese si plasaritjet dhe gropat duhet të mbushen duke përdorur EPOFLOOR UNI 8900 (A+B). EPOFLOOR UNI 8900 duhet të aplikohet 24 orë pas aplikimit të astarit.

#### 2. Përzjerja e EPOFLOOR UNI 8900

Komponentet A dhe B janë paketuar në proporcione të paracaktuara përzjerje. Fillimisht, komponenti A duhet të përzihet mirë në enë e saj. Më pas e gjithë sasia e komponentit B duhet të shtohet në komponent A. Është e rëndësishme që të bëhet një përzjerje e mirë pranë anëve dhe në fund të kovës, për të arritur shpërndarje uniforme të sforcuesit. Përzjerja bëhet me një mikser me shpejtësi të ulët dhe vazhdohet deri sa përzjerja të bëhet plotësisht uniforme (rreth për 3 minuta).

#### 3. Mënyra e aplikimit - Konsumi

Në varësi të sipërfaqes finale ka dy mënyra aplikimi:

a) Sipërfaqe finale e lëmuar

Përzjerja epokside hidhet në dysheme në trashësi 2 – 3 mm dhe hapet duke përdorur një mallë të dhëmbëzuar. Konsumi i EPOFLOOR UNI 8900(A+B) është 0.6 Kg/m<sup>2</sup> per mm trashësi. Konsumi i rërës kuarcore 1.2 Kg/mm<sup>2</sup> per mm trashësi. Shtresa niveluese duhet të kalohet me një rrul me gjemba në mënyrë që të largohet ajri i mbetur brenda shtresës dhe që të evitohen hapësirat boshe.

b) Sipërfaqe finale e ashpër

Fillimisht përzjerja epokside aplikohet në mënyrë që u shpjegua në pikën a) për sipërfaqet e lëmuara. Kur shtresa është akoma e pa forcuar rërë kuarcore me granulometri 0 – 0.4 mm ose 0.4 – 0.8 mm, kjo sipas dëshirës hidhet mbi produkt. Konsumi i rërës kuarcore është afërsisht 3 Kg/m<sup>2</sup>. Pas forcimit të EPOFLOOR UNI 8900 pjesa e pa lidhur e rërës largohet duke përdorur fshesë me vakuum. Në fund një shtresë EPOFLOOR UNI 8900 aplikohet me rrul. Konsumi është 400 – 600 g/m<sup>2</sup>.

#### PAKETIMI

EPOFLOOR UNI 8900 është i disponueshëm në paketim 5 Kg dhe 10 Kg (A+B).

#### JETËGJATËSIA DHE RUAJTJA

24 muaj nëse ruhet në paketimin origjinal dhe të pahapur e të paeksponuar ndaj rrezeve të diellit dhe ngricës.



**TË DHËNAT TEKNIKE**

Baza kimike (A+B)	rezine epokside 2 komponentëshe
Densiteti (A+B)	2,1 Kg/l
Raporti Përzjerjes (A:B)	5: 1: 6 në peshë
Jetëgjatësia	afërsisht. 40 min në +20°C
Temperatura minimale për forcim	+8°C
Shkelet	pas 24 hours at +23°C
Rezistencat finale	pas 7 days at +23°C
Rezistenca në shtypje	110 N/mm <sup>2</sup> (EN 13892 - 2)
Rezistenca në perkulje	62 N/mm <sup>2</sup> (EN 13892 - 2)
Forca ngjithëse	4 N/mm <sup>2</sup> (pika e thyerjes së betonit)
Trashësia maksimale	3 mm